



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.159**

**3 dhjetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 339 datë 28.10.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë.....	8327
Ligj nr.10 340 datë 28.10.2010	Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe sh.a.-ve në pronësi të pushtetit vendor.....	8337
Ligj nr.10 341 datë 28.10.2010	Për standardizimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....	8338
Ligj nr.10 342 datë 28.10.2010	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2009.....	8341
Ligj nr.10 343 datë 28.10.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	8342
Ligj nr.10 344 datë 4.11.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar” .....	8346
Ligj nr.10 345 datë 4.11.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar.....	8350
Ligj nr.10 346 datë 4.11.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”.....	8351
Vendim i Kuvendit nr.67, datë 4.11.2010	Për zgjedhjen e zonjës Florina Nuni komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit.....	8355

Vendim i Kuvendit nr.68, datë 4.11.2010	Për zgjedhjen e zonjës Anila Nepravishta komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit.....	8355
Vendim i Kuvendit nr.69, datë 4.11.2010	Për zgjedhjen e zotit Arben Shkëmbi komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit.....	8356
Vendim i Kuvendit nr.70, datë 4.11.2010	Për zgjedhjen e zotit Ramiz Çobaj anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.....	8356
Vendim i Kuvendit nr.71, datë 4.11.2010	Për zgjedhjen e zotit Fatmir Tafaj anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.....	8357
Vendim i KM nr.840, datë 21.10.2010	Për vendosjen e kabllor nëndetare ndërkombëtare me fibër optike Bari (Itali) - Gjiri i Lalzit (Shqipëri), projekti “Balkans – Italy Network” .....	8357
Vendim i KM nr.862, datë 27.10.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.34, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për sistemimin në apartamente banimi të familjeve, që banojnë në territorin e portit të Durrësit” .....	8358
Vendim i KM nr.952, datë 24.11.2010	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të zhvillojë procedurën e prokurimit, me objekt “Ndërtimi i rrugës Komuna e Parisit - Rruga e Re, Tiranë - Elbasan” .....	8358
Vendim i KM nr.968, datë 1.12.2010	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës.....	8359
Vendim i KM nr.970, datë 1.12.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 9.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyrore” .....	8360
Vendim i KM nr.971, datë 1.12.2010	Për dhënie fondi për përballimin e situatës emergjente, të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmbytjeve natyrore.....	8360
Udhëzim i METE nr.721, datë 27.10.2010	Për kriteret e organizimit dhe drejtimit të qendrave të këshillimit të konsumatorëve.....	8361
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Lutfi Mara.....	8362

**LIGJ**  
**Nr.10 339, datë 28.10.2010**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BIOMJEKËSINË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6760, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**KONVENTË**

**PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE DINJITETIT TË QENIEVE NJERËZORE  
NË LIDHJE ME APLIKIMIN E BIOLOGJISË DHE MJEKËSISË: KONVENTË MBI TË DREJTAT E  
NJERIUT DHE BIOMJEKËSISË**

Preambul

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet e tjera dhe Komuniteti European, nënshkrues të kësaj konvente,

*duke pasur* parasysh Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të 4 nëntorit 1950;

*duke pasur* parasysh Kartën Sociale Europiane të 18 tetorit 1961;

*duke pasur* parasysh marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike dhe marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetor 1966;

*duke pasur* parasysh konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale të 28 janarit 1981;

*duke pasur* gjithashtu parasysh Konventën për të drejtat e fëmijëve të 20 nëntorit 1989;

*duke marrë* në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij dhe se një prej metodave me anë të së cilës ky qëllim do të arrihet është mbrojtja dhe njohja e mëtejshme e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

*të ndërgjegjshme* për përshpejtimin e zhvillimeve në biologji dhe mjekësi;

*të bindura* për nevojën për të respektuar qenien njerëzore dhe si individ, edhe si pjesëtar të racës njerëzore dhe duke njohur rëndësinë e garantimit të dinjitetit të qenieve njerëzore;

*të ndërgjegjshme* se keqpërdorimi i biologjisë dhe mjekësisë mund të çojë në akte që rrezikojnë dinjitetin njerëzor;

*duke pohuar* se progresi në biologji dhe mjekësi duhet të përdoret për përfitimin e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm;

*duke theksuar* nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar, në mënyrë që i gjithë njerëzimi të mund të gëzojë përfitimet e biologjisë dhe mjekësisë;

*duke njohur* rëndësinë e promovimit të debatit publik, mbi çështjet e ngritura nga aplikimi i biologjisë dhe mjekësisë dhe përgjigjet që duhet t'u jepen atyre;

*duke dëshiruar* t'u kujtojnë të gjithë anëtarëve të shoqërisë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;

*duke marrë* parasysh punën e Asamblesë Parlamentare në këtë fushë, përfshirë rekomandimin 1160 (1991) mbi përgatitjen e një konvente për bioetikën;

*të vendosura* për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat dhe liritë themelore të individit në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë,

*kanë rënë dakord* si më poshtë:

## KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### **Qëllimi dhe objekti**

Palët e kësaj konvente mbrojnë dinjitetin dhe identitetin e të gjitha qenieve njerëzore dhe i garantojnë çdokujt, pa diskriminim, respekt për integritetin e tyre, si dhe për të drejtat e tjera dhe liritë themelore në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë.

Çdo palë, sipas ligjit të saj të brendshëm, merr masat e nevojshme për t'u dhënë fuqi dispozitave të kësaj konvente.

### Neni 2

#### **Supremacia e qenies njerëzore**

Interesat dhe mirëqenia e qenieve njerëzore kanë përparësi ndaj interesit të vetëm të shoqërisë ose shkencës.

### Neni 3

#### **Aksesi i barabartë për kujdes shëndetësor**

Palët, duke marrë parasysh nevojat shëndetësore dhe burimet e disponueshme, marrin masat e përshtatshme, me synim që të garantojnë brenda juridiksionit të tyre akses të barabartë për kujdes shëndetësor të cilësisë së duhur.

### Neni 4

#### **Standardet profesionale**

Çdo ndërhyrje në fushën shëndetësore, duke përfshirë kërkimet, duhet të kryhet në përputhje me detyrimet dhe standardet përkatëse profesionale.

## KAPITULLI II MIRATIMI

### Neni 5

#### **Rregulli i përgjithshëm**

Një ndërhyrje në fushën shëndetësore mund të kryhet vetëm pasi personi i interesuar të ketë dhënë pëlqimin e lirë dhe të bazuar në lidhje me të.

Ky person merr informacionin e nevojshëm paraprak për qëllimin dhe natyrën e ndërhyrjes, si dhe për pasojat dhe rreziqet e saj.

Në çdo kohë, personi në fjalë mund të jetë i lirë për të tërhequr pëlqimin e dhënë.

#### Neni 6

##### **Mbrojtja e personave të paaftë për dhënien e pëlqimit**

1. Në bazë të neneve 17 dhe 20 më poshtë, një ndërhyrje mund të kryhet vetëm për një person të paaftë për dhënien e pëlqimit për përfitimin e tij ose të saj të drejtpërdrejtë.

2. Kur, sipas ligjit, një i mitur nuk është i aftë për të dhënë pëlqimin në lidhje me një ndërhyrje, ndërhyrja mund të kryhet vetëm me autorizimin e përfaqësuesit të tij ose të saj ose të një autoriteti ose personi ose organi të parashikuar me ligj.

Opinionin e të miturit merret në konsideratë si një faktor gjithnjë e më përcaktues në raport me moshën e tij ose të saj dhe shkallën e pjekurisë.

3. Kur, sipas ligjit, një person në moshë madhore nuk është i aftë për të dhënë pëlqimin mbi një ndërhyrje për shkak të një paaftësie mendore, sëmundjeje ose për arsye të ngjashme, ndërhyrja mund të kryhet vetëm me autorizimin e përfaqësuesit të tij ose të saj ose të një autoriteti ose personi, ose organi të parashikuar me ligj.

4. Individit përkatës, autoritetit, personit ose organit të përmendur në paragrafët 2 dhe 3 më sipër i jepet nën të njëjtat kushte informacioni i përmendur në nenin 5.

5. Autorizimi i përmendur në paragrafët 2 dhe 3 më sipër mund të tërhiqet në çdo kohë në interesin më të mirë të personit përkatës.

#### Neni 7

##### **Mbrojtja e personave me çrregullime mendore**

Në bazë të kushteve mbrojtëse të parashikuara me ligj, duke përfshirë procedurat mbikëqyrëse, të kontrollit dhe apelit, një person me çrregullime të rënda mendore mund t'i nënshtrohet, pa miratimin e tij ose të saj, një ndërhyrjeje të synuar për trajtimin e çrregullimit të tij ose të saj mendor vetëm kur pa këtë trajtim, shëndeti i tij ose i saj mund të dëmtohet seriozisht.

#### Neni 8

##### **Situata emergjente**

Kur për shkak të një situate emergjente nuk mund të merret miratimi i duhur, mund të kryhet menjëherë çdo ndërhyrje e nevojshme nga pikëpamja mjekësore në interes të shëndetit të individit përkatës.

#### Neni 9

##### **Dëshirat e shprehura më parë**

Dëshirat e shprehura më parë, në lidhje me një ndërhyrje mjekësore nga një pacient që në kohën e ndërhyrjes nuk është i aftë të shprehë dëshirat e tij ose të saj, merren në konsideratë.

### KAPITULLI III

#### JETA PRIVATE DHE E DREJTA PËR INFORMIM

#### Neni 10

##### **Jeta private dhe e drejta për informim**

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës private në lidhje me informimin rreth shëndetit të tij ose të saj.

2. Çdokush ka të drejtë të dijë çdo informacion të mbledhur rreth shëndetit të tij ose të saj. Megjithatë, respektohen dëshirat e individëve për të mos u informuar në këtë mënyrë.

3. Në raste të veçanta, mund të vendosen kufizime me ligj mbi ushtrimin e të drejtave në përmbajtje të paragrafit 2, në interes të pacientit.

#### KAPITULLI IV GJENOMI NJERËZOR

##### Neni 11 **Mosdiskriminimi**

Ndalohet çdo formë diskriminimi kundër një personi për arsye të trashëgimisë së tij ose të saj gjenetike.

##### Neni 12 **Testet gjenetike parashikuese**

Testet që parashikojnë sëmundje gjenetike ose që shërbejnë për të identifikuar subjektin si mbartës të një gjeni përgjegjës për një sëmundje ose për të zbuluar një predispozitë gjenetike ose prirje ndaj një sëmundjeje, mund të kryhen vetëm për qëllime shëndetësore ose kërkime shkencore të lidhura me qëllime shëndetësore dhe i nënshtrohen konsulencës së duhur gjenetike.

##### Neni 13 **Ndërhyrjet në gjenomin njerëzor**

Një ndërhyrje që synon të modifikojë gjenomin njerëzor mund të ndërmerret vetëm për qëllime parandaluese, diagnostikuese ose terapeutike dhe vetëm nëse qëllimi i saj nuk është paraqitja e ndonjë modifikimi në gjenomin e një pasardhësi.

##### Neni 14 **Mospërzgjedhja e gjinisë**

Përdorimi i teknikave të riprodhimit me ndihmën e elementeve mjekësore nuk lejohet për qëllim të zgjedhjes së gjinisë së fëmijës së ardhshëm, përveç rasteve kur duhet të shmanget një sëmundje e rëndë e trashëguar e lidhur me gjininë.

#### KAPITULLI V KËRKIMET SHKENCORE

##### Neni 15 **Rregulli i përgjithshëm**

Kërkimet shkencore në fushën e biologjisë dhe mjekësisë kryhen lirisht, në bazë të dispozitave të kësaj konvente dhe dispozitave të tjera ligjore që garantojnë mbrojtjen e qenieve njerëzore.

##### Neni 16 **Mbrojtja e personave që u nënshtrohen kërkimeve**

Kërkimet për një person mund të ndërmerren vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i) Nuk ka asnjë alternativë të ngjashme efektive për kërkime për qeniet njerëzore;
- ii) Rreziqet që mund të pësohen nga ai person janë proporcionale me përfitimet e mundshme të kërkimit;

iii) Projekti kërkimor është miratuar nga organi kompetent pas shqyrtimit të pavarur të vlerave të tij shkencore, duke përfshirë vlerësimin e rëndësisë së qëllimit të kërkimit dhe rishikimit shumëdisiplinor të pranueshmërisë së tij etike;

iv) Personat që u nënshtrohen kërkimeve janë informuar për të drejtat e tyre dhe garancitë e parashikuara me ligj për mbrojtjen e tyre;

v) Pëlqimi i nevojshëm që parashikohet sipas nenit 5 është dhënë shprehimisht, specifikisht dhe është i dokumentuar.

Ky pëlqim mund të tërhiqet lirisht në çdo kohë.

#### Neni 17

### **Mbrojtja e personave të paaftë për dhënien e pëlqimit në lidhje me kërkimin**

1. Kërkimet për një person të paaftë për dhënien e pëlqimit, siç përcaktohet në nenin 5, mund të ndërmerren vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i) Plotësohen kushtet e parashtruara në nenin 16, nënparagrafët “i” deri “iv”;

ii) Rezultatet e kërkimit mund të nxjerrin përfitim real dhe të drejtpërdrejtë për shëndetin e tij ose të saj;

iii) Kërkime të ngjashme efektive nuk mund të kryhen për individë të aftë për dhënien e pëlqimit;

iv) Autorizimi i nevojshëm i parashikuar në nenin 6 është dhënë specifikisht dhe me shkrim; dhe

v) Personi përkatës nuk shpreh kundërshtim.

2. Në raste të veçanta dhe sipas kushteve mbrojtëse të parashikuara me ligj, kur kërkimi nuk mund të nxjerrë rezultate të një përfitimi të drejtpërdrejtë për shëndetin e personit përkatës, ky kërkim mund të autorizohet në bazë të kushteve të parashtruara në paragrafin 1, nënparagrafin “i”, “iii”, “iv” dhe “v” më sipërm dhe kushteve të mëposhtme shtesë:

i) Njëpërmjet përmirësimit të dukshëm, në kuptimin shkencor, të gjendjes, sëmundjes ose çrregullimit të individit, kërkimi synon të kontribuojë në arritjen përfundimtare të rezultateve që mund të ofrojnë përfitime për personin përkatës ose për persona të tjerë në të njëjtën grupmoshë ose që vuajnë nga e njëjta sëmundje ose çrregullim ose që janë në të njëjtën gjendje;

ii) Kërkimi përfshin vetëm rrezikun dhe barrën minimale për individin përkatës.

#### Neni 18

### **Kërkimet për embrionin *in vitro***

1. Kur ligji lejon kërkime për embrionet *in vitro*, ai duhet të garantojë mbrojtje të mjaftueshme të embrionit.

2. Ndalohet krijimi i embrioneve njerëzore për qëllime kërkimore.

## KAPITULLI VI

### HEQJA E ORGANEVE DHE INDEVE NGA DHURUESIT E GJALLË PËR QËLLIME TRANSPLANTIMI

#### Neni 19

### **Rregulli i përgjithshëm**

1. Heqja e organeve ose indeve nga një person i gjallë për qëllime transplantimi mund të kryhet vetëm për përfitime terapeutike të marrësit dhe kur nuk ka ndonjë organ ose ind të përshtatshëm të disponueshëm nga një person i vdekur dhe asnjë metodë tjetër të ngjashme dhe efektive terapeutike.

2. Pëlqimi i nevojshëm që parashikohet në nenin 5 duhet të jetë dhënë shprehimisht dhe specifikisht ose me shkrim, ose para një organi zyrtar.

## Neni 20

### **Mbrojtja e personave të paaftë për dhënien e pëlqimit për heqjen e organit**

1. Asnjë heqje e organit ose indit nuk mund të kryhet ndaj një personi të paaftë për dhënien e pëlqimit sipas nenit 5.

2. Në raste të veçanta dhe nën kushte mbrojtëse të parashikuara me ligj, mund të autorizohet heqja e indit regjenerues nga një person i paaftë për dhënien e pëlqimit, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- i) Nuk ka një dispozicion dhurues të përputhshëm, të aftë për dhënien e pëlqimit;
- ii) Marrësi është vëlla ose motër i dhuruesit;
- iii) Dhurimi duhet të shpëtojë jetën e marrësit;
- iv) Autorizimi i parashikuar sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 6 është dhënë specifikisht dhe me shkrim, në përputhje me ligjin dhe miratimin e organit kompetent;
- v) Dhuruesi i mundshëm përkatës nuk shpreh kundërshtim.

## KAPITULLI VII

### **NDALIMI I FITIMIT FINANCIAR DHE ELIMINIMI I NJË PJESE TË TRUPIT NJERËZOR**

## Neni 21

### **Ndalimi i fitimit financiar**

Trupi njerëzor dhe pjesët e tij, si të tilla, nuk duhet të bëhen shkak për fitim financiar.

## Neni 22

### **Eliminimi i pjesës së hequr të trupit njerëzor**

Kur gjatë një ndërhyrjeje është hequr ndonjë pjesë e një trupi njerëzor, ajo mund të ruhet dhe përdoret për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin ishte hequr, vetëm nëse kryhet në përputhje me informacionin e duhur dhe procedurat e miratimit.

## KAPITULLI VIII

### **SHKELJA E DISPOZITAVE TË KONVENTËS**

## Neni 23

### **Shkelja e të drejtave ose parimeve**

Palët ofrojnë pa vonesë mbrojtjen e duhur gjyqësore për të parandaluar ose ndaluar për shkelje të paligjshme të të drejtave dhe parimeve të parashtruara në këtë konventë.

## Neni 24

### **Kompensimi për dëmin e padrejtë**

Personi i cili ka pësuar dëm të padrejtë që shkaktohet nga një ndërhyrje, ka të drejtën e një kompensimi të drejtë sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara me ligj.

## Neni 25

### **Sanksionet**

Palët parashikojnë sanksione të përshtatshme që zbatohen në rast të shkeljes së dispozitave në përmbajtje të kësaj konvente.



KAPITULLI IX  
MARRËDHËNIA MIDIS KËSAJ KONVENTE DHE DISPOZITAVE TË TJERA

Neni 26

**Kufizimet mbi ushtrimin e të drejtave**

1. Nuk vendoset asnjë kufizim mbi ushtrimin e të drejtave dhe kushteve mbrojtëse në përmbajtje të kësaj konvente, të ndryshme nga ato që parashikohen me ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

2. Kufizimet e parashikuara në paragrafin pararendës nuk mund të vendosen për nenet 11, 13, 14, 16, 17, 19, 20 dhe 21.

Neni 27

**Mbrojtja më e zgjeruar**

Asnjë prej dispozitave të kësaj konvente nuk interpretohet sikur kufizon ose ndryshe cenon mundësinë e një pale për dhënien e një mase mbrojtëse më të zgjeruar sesa përcaktohet në këtë konventë, në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë.

KAPITULLI X  
DEBATI PUBLIK

Neni 28

**Debati publik**

Palët e kësaj konvente kujdesen që çështjet themelore të ngritura nga zhvillimet e biologjisë dhe mjekësisë t'i nënshtrohen diskutimit të përshtatshëm publik, duke marrë parasysh në veçanti implikimet përkatëse mjekësore, sociale, ekonomike, etike dhe ligjore dhe që aplikimi i tyre i mundshëm të bëhet subjekt i konsultimit përkatës.

KAPITULLI XI  
INTERPRETIMI DHE VIJIMËSIA E KONVENTËS

Neni 29

**Interpretimi i konventës**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mund të ofrojë, pa iu referuar drejtpërdrejt ndonjë procedimi specifik të mbetur pezull në një gjykatë, konsulencë për çështje ligjore në lidhje me interpretimin e kësaj konvente me kërkesën e:

- qeverisë së një pale, pasi të ketë informuar palët e tjera;
- komitetit të krijuar sipas nenit 32, me anëtarësim të kufizuar ndaj përfaqësuesve të palëve të kësaj konvente, me një vendim të miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të votave.

Neni 30

**Raportet për zbatimin e konventës**

Me marrjen e një kërkesë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, çdo palë jep një shpjegim mbi mënyrën në të cilën ligji i saj i brendshëm garanton zbatimin efektiv të dispozitave të konventës.

## KAPITULLI XII PROTOKOLLET

### Neni 31 Protokollet

Protokollet mund të lidhen në zbatim të nenit 32, me synim zhvillimin në fusha specifike të parimeve në përmbajtje të kësaj konvente.

Protokollet janë të hapura për nënshkrim nga nënshkruesit e konventës. Ato i nënshtrohen ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një nënshkrues mund të mos ratifikojë, pranojë ose miratojë protokollet pa ratifikuar, pranuar ose miratuar më parë, ose njëkohësisht konventën.

## KAPITULLI XIII AMENDIMET E KONVENTËS

### Neni 32 Amendimet e konventës

1. Detyrat e dhëna “Komitetit” sipas këtij neni dhe nenit 29 përmbushen nga Komiteti Drejtues për Biotekën (CDBI) ose nga një komitetit tjetër i caktuar për ta bërë këtë nga Komiteti i Ministrave.

2. Pa cenuar dispozitat specifike të nenit 20, çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës, si dhe çdo palë e kësaj konvente që nuk është anëtare e Këshillit të Europës, mund të përfaqësohet dhe të ketë një votë në Komitet kur Komiteti kryhen detyrat që i caktohen atij nga kjo konventë.

3. Çdo shtet i përmendur në nenin 33 ose i ftuar për të aderuar në konventë në përputhje me dispozitat e nenit 34, që nuk është palë e kësaj konvente, mund të përfaqësohet në komitet nga një vëzhgues. Nëse Komuniteti Europian nuk është palë, ai mund të përfaqësohet në komitet nga një vëzhgues.

4. Me qëllim monitorimin e zhvillimeve shkencore, kjo konventë rishikohet brenda Komitetit jo më vonë se pesë vjet nga hyrja e saj në fuqi dhe më pas, në ato intervale të caktuara nga Komiteti.

5. Çdo propozim për një amendim të kësaj konvente dhe çdo propozim për një protokoll ose amendim të një protokollit, të paraqitur nga një palë, komiteti ose Komiteti i Ministrave, i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili ua përcjell shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit Europian, çdo nënshkruesi, çdo pale, çdo shteti të ftuar për të nënshkruar këtë konventë në përputhje me dispozitat e nenit 33 dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në të, në përputhje me dispozitat e nenit 34.

6. Komiteti do të shqyrtojë propozimin jo më vonë se dy muaj pasi të jetë paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm në përputhje me paragrafin 5. Komiteti paraqet për miratim në Komitetin e Ministrave tekstin e miratuar nga një shumicë prej dy të tretave të votave. Pas miratimit, ky tekst i paraqitet palëve për ratifikim, pranim ose miratim.

7. Çdo amendim do të hyjë në fuqi në lidhje me ato palë që e kanë pranuar atë, ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën pesë palë, duke përfshirë të paktën katër shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë. Në lidhje me çdo palë që e pranon më pas, amendimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pas datës në të cilën pala ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

## KAPITULLI XIV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 33

#### **Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe nga Komuniteti Europian.
2. Kjo konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit.  
Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën pesë shtete, duke përfshirë të paktën katër shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nga konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni.
4. Në lidhje me çdo nënshkrues që më pas shpreh pëlqimin për të qenë i lidhur me të, konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

### Neni 34

#### **Shtetet joanëtare**

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, pas konsultimit me palët, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës të aderojë në këtë konventë me anë të një vendimi të marrë nga shumica, të parashikuar në nenin 20, paragrafi "d" të statutit të Këshillit të Europës dhe nga vota unanime e përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të autorizuara për të qenë anëtar i Komitetit të Ministrave.
2. Në lidhje me një shtet aderues, konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

### Neni 35

#### **Territoret**

1. Në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, çdo nënshkrues mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet konventa. Çdo shtet tjetër mund të formulojë të njëjtën deklaratë në depozitim të instrumentit të tij të aderimit.
2. Në çdo datë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo palë mund të shtrijë zbatimin e kësaj konvente në ndonjë territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilit autorizohet për të ndërmarrë angazhime. Në lidhje me këtë territor, konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Në lidhje me ndonjë territor të përcaktuar në këtë deklaratë, çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve pararendës, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

### Neni 36

#### **Rezervat**

1. Gjatë nënshkrimit të kësaj konvente ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, çdo shtet dhe Komuniteti Europian mund të bëjë rezervë në lidhje me një

dispozitë të veçantë të konventës në shkallën që ndonjë ligj në atë kohë në fuqi në territorin e saj, nuk është në përputhje me dispozitën. Rezervat e një karakteri të përgjithshëm nuk lejohen sipas këtij neni.

2. Çdo rezervë e bërë sipas këtij neni përmban një deklaratë të shkurtër të ligjit përkatës.

3. Në lidhje me territorin përkatës, çdo palë që shtrin zbatimin e kësaj konvente në një territor të përmendur në deklaratën e përmendur në nenin 35, paragrafi 2, mund të bëjë rezervë në përputhje me dispozitat e paragrafëve pararendës.

4. Çdo palë që ka bërë rezervën e përmendur në këtë nen, mund ta tërheqë atë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej një muaji pas datës së marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 37 **Denoncimi**

1. Çdo palë mund ta denoncojë këtë konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas skadimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 38 **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit, Komunitetin European, çdo nënshkrues, çdo palë dhe çdo shtet tjetër që është ftuar për të aderuar në këtë konventë, në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenet 33 ose 34;
- d) çdo amendim të protokollit të miratuar në përputhje me nenin 32 dhe datën në të cilën ky amendim ose protokoll hyn në fuqi;
- e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit 35;
- f) çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 36;
- g) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim në lidhje me konventën.

Në dëshmi sa më sipër, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Ovideo (Austurias) më 4 prill 1997, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike, në një kopje të vetme që depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës, Komunitetit European, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj konvente dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë konventë.

ETS nr.164

Traktat i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe nga Komuniteti European Ekonomik dhe për aderim nga shtetet të tjera joanëtare.

Hapja për nënshkrim:

Vendi: Ovideo

Data: 4.4.1997

Hyrja në fuqi:

Kushtet: 5 ratifikime, duke përfshirë 4 shtete anëtare

Datë: 1.12.1999

Protokoll shtesë (ETS 168)

Protokoll shtesë (Transplantimi) [ETS 186]

**LIGJ**  
**Nr.10 340, datë 28.10.2010**

**PËR PAGESËN E DETYRIMEVE NDAJ TË TRETËVE TË NDËRMARRJEVE DHE SHA-VE**  
**NË PRONËSI TË PUSHTETIT VENDOR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Në rastet kur njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ofrojnë shërbimet dhe mallrat publike nëpërmjet ndërmarrjeve publike, shoqërive aksionare ose formave të privatizimit të tyre, këto njësi janë përgjegjëse për menaxhimin dhe për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria e tyre.

Neni 2

Në rastet kur ndërmarrjet publike dhe/ose SHA-të, në pronësi të pushtetit vendor, nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre ndaj të tretëve, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për pagimin e tyre.

Neni 3

Për rastet e përcaktuara sipas nenit 2 të këtij ligji dhe kur ndërmarrjet dhe/ose SHA-të subvencionohen nga pushteti qendror dhe/ose vendor, Ministri i Financave, nëpërmjet strukturave të tij, verifikon arsyet e mospagesës së detyrimit ndaj të tretëve vetëm për çështjet që lidhen me interesat jetikë dhe bazë të komunitetit (furnizimin me ujë të pijshëm, pastrimin e mbeturinave, kanalizimet etj.).

Kur Ministri i Financave, bazuar në verifikimin e kryer, vlerëson se përgjegjëse për detyrimin është njësia e qeverisjes vendore përkatëse, nëpërmjet degëve të thesarit, bën bllokimin e veprimeve financiare të njësisë vendore që ka në pronësi ndërmarrjen dhe/ose SHA-në, për detyrimet ndaj të tretëve të këtyre ndërmarrjeve dhe/ose SHA-ve deri në ditën e likuidimit të detyrimit.

Neni 4

Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët për zbatimin e këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6761, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 341, datë 28.10.2010**

**PËR STANDARDIZIMIN USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për:

- a) organizimin dhe funksionimin e sistemit të standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- b) përcaktimin e strukturave dhe të përgjegjësive të tyre;
- c) dhënien e fuqisë autoritetit më të lartë për pranimin e marrëveshjeve të standardizimit STANAG/AP të NATO-s dhe të standardeve për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura në fushën operacionale, materiale e administrative.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për standardizimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përfshirë procedurat e nevojshme për përzgjedhjen, pranimin, publikimin e zbatimin e marrëveshjeve të standardizimit STANAG/AP-ve të NATO-s dhe të standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Standardizim” është zhvillimi dhe zbatimi i koncepteve, i procedurave dhe i rregullave të përbashkëta, me synimin për të zhvilluar e për të mbajtur kapacitetet e duhura operacionale në tri nivelet e standardizimit në fushën ushtarake; të përafrueshmërisë, të ndërkëmbyeshmërisë, të përputhshmërisë, në fushat e operacioneve, të procedurave, të materialeve, si dhe ato teknike e administrative, për të arritur ndërveprimin optimal të tyre.
2. “Marrëveshje standardizimi (STANAG)” është arritja e një marrëveshjeje ndërmjet disa shteteve ose të gjitha shteteve anëtare të Aleancës, për të adoptuar përdorimin e pajisjeve ushtarake të njëjta ose të përafërta, përfshirë municione, materiale furnizimi dhe rezerva, si dhe të procedurave operacionale, logjistike dhe administrative të njëjta. Pranimi nga vendet pjesëmarrëse i një publikimi të Aleancës nga Agjencia e NATO-s për Standardizimin emërtohet si një marrëveshje standardizimi.
3. “Përafrueshmëria” është ngjashmëria e produkteve, proceseve ose e shërbimeve që ofrohen për përdorim të përbashkët, nga vendet e Aleancës, në kushte të caktuara, për të përmbushur kërkesa të paracaktuara, pa shkaktuar efekte të padëshiruara.
4. “Ndërkëmbyeshmëria” është aftësia e një produkti, e një procesi ose e një shërbimi, për t’u përdorur në mënyrë të shkëmbyeshme në vend të një produkti, procesi a shërbimi tjetër që përmbush kërkesa të njëjta.

5. “Përputhshmëria” është gjendja fundore e arritur kur vendet përdorin doktrina, procedura ose pajisje të njëjta.

6. “Publikimi i Aleancës (AP)” është dokumenti zyrtar i standardizimit në NATO, për të cilin disa ose të gjitha vendet e NATO-s bien dakord ta përdorin, si një dokument autoritar të zbatimit të përbashkët, dhe që u jepet për zbatim të gjithë përdoruesve të të gjitha niveleve.

7. “Autoriteti propozues i STANAG-ut” është komanda/drejtoria/institucioni që propozon fillimin e procesit të ratifikimit të një STANAG-u.

8. “Autoriteti kujdestar” është komanda/drejtoria/institucioni që nis procesin e ratifikimit të një STANAG-u/AP-je.

9. “Grupi i ekspertëve” është një organizëm ose një grup pune në varësi të një autoriteti kujdestar, të cilit i jepet detyrë nga ky i fundit për zhvillimin e projekteve të dokumenteve normative të standardizimit.

10. “Personi përgjegjës i standardizimit” është personi mbikëqyrës dhe që shërben si pikë kontakti për zhvillimin e projekteve të dokumenteve normative të standardizimit. Ai është, në përgjithësi, kryetari i grupit të ekspertëve për vlerësimin, zbatimin dhe rishikimin e tyre.

11. “Raporti i vlerësimit” është një raport i hollësishëm i vlerësimit për secilin STANAG/AP, që shpreh implikimet e mundshme strukturore e infrastrukturore të pajisjeve e të sistemeve, të trajnimit e të arsimimit, të koncepteve e doktrinave, si dhe ato financiare për zbatimin e tij në një periudhë kohore të caktuar.

12. “Propozimi” është faza e fillimit për përpunimin e një STANAG-u. Propozimet e standardizimit i paraqiten, nga vendet dhe organizmat e NATO-s, autoritetit përgjegjës të detyrës, duke përdorur një formular të standardizuar.

13. “Pranimi” është deklarimi, me anë të cilit një vend i NATO-s pranon zyrtarisht, me ose pa rezerva, përmbajtjen e një marrëveshjeje standardizimi të NATO-s (STANAG).

14. “Shpallja” është një deklarami zyrtar nga autoriteti kompetent, i cili i jep STANAG-ut një efekt zbatimi në të gjitha vendet e NATO-s. Shpallja bëhet nga Drejtori i Agjencisë së NATO-s për Standardizimin (NSA) kur plotësohen kushtet e tij.

#### Neni 4

### **Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura**

Qëllimi i standardizimit ushtarak është pranimi dhe zbatimi nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë i standardeve të NATO-s dhe i standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura, për të siguruar rritjen e ndërveprimit ndërmjet llojeve të forcave e të shërbimeve brenda Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Aleancës.

#### Neni 5

### **Autoritetet, organizmat e standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura dhe përgjegjësitë kryesore të tyre**

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti më i lartë civil në sistemin e standardizimit në Forcat e Armatosura. Ai përgjigjet, në emër të Republikës së Shqipërisë, për miratimin e politikave të zhvillimit të standardizimit në Forcat e Armatosura dhe pranimin e STANAG-ut/AP-ve të NATO-s.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është autoriteti më i lartë ushtarak, që përgjigjet për funksionimin e sistemit të standardizimit në Forcat e Armatosura.

3. Bordi i standardizimit në Ministrinë e Mbrojtjes është organ i posaçëm (*ad hoc*), i cili shqyrton, për t’u miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, planet për pranimin e standardeve të NATO-s, të standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura, si dhe praktikat dokumentare të paraqitura nga organizmat e përcaktuar në sistemin e standardizimit në Forcat e Armatosura. Planet për pranimin e STANAG-ut/AP-ve i propozohen Ministrisë të Mbrojtjes nëpërmjet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bordit të standardizimit përcaktohet me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes.

## Neni 6

### **Planifikimi i standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura**

1. Standardizimi është përgjegjësi e strukturave dhe e komandave të të gjitha niveleve, për të përmbushur misionin tyre, i cili bazohet në objektivat parësorë të zhvillimit të forcës përkatëse.

2. Bordi i standardizimit ia dërgon për miratim Ministrin të Mbrojtjes planin e standardizimit në Forcat e Armatosura, ku përcaktohen:

- a) autoriteti kujdestar;
- b) afatet e përfundimit të raportit të vlerësimit të STANAG-ut/AP-ve;
- c) gjuha, sipas së cilës zbatohet STANAG-u/AP-ja.

## Neni 7

### **Pranimi i STANAG-ut/AP-së të NATO-s dhe standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura**

1. Autoriteti kujdestar, në bazë të planit të standardizimit të Forcave të Armatosura, nis punën për studimin e pranimit të STANAG-ut/AP-së, sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës të NATO-s.

2. Autoriteti kujdestar i STANAG-ut/AP-së cakton grupe ekspertësh për vlerësimin dhe për përcaktimin e statusit të pranimit të tij. Kryetari i grupit të ekspertëve është personi përgjegjës i STANAG-ut/AP-së dhe njihet në NATO si pikë kontakti e vendit për këtë marrëveshje standardizimi.

3. Grupet e ekspertëve hartojnë raportin e vlerësimit të STANAG-ut/AP-së, i cili, sipas procedurave të përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes, diskutohet në bordin e standardizimit dhe pranohet nga Ministri i Mbrojtjes.

4. Në rastet kur gjykohet e nevojshme nga personi përgjegjës i standardizimit dhe autoriteti kujdestar, raporti i vlerësimit të STANAG-ut/AP-së dërgohet për mendim në ministrinë dhe zyrat e tjera administrative, të cilat janë të detyruara t'ia dërgojnë opinionin e tyre përdoruesit brenda afateve ligjore. Nëse ky opinion nuk është dërguar nga ministrinë dhe zyrat e tjera administrative brenda afatit, do të vlerësohet se ato janë dakord me standardin e propozuar.

5. Format i pranimit të STANAG-ut/AP-së duhet të përmbajë:

- a) titullin dhe shënimin e STANAG-ut/AP-së (numri; botimi-muaji-viti; titulli, në anglisht);
- b) përkthimin e titullit të origjinalit;
- c) vendimin e miratimit në bordin e standardizimit;
- ç) shenjen e referencës S.U.SH. STANAG/AP XXXX (S.U.SH - Standard Ushtarak Shqiptar).

## Neni 8

### **Shpallja e STANAG-ut/AP-së të pranuar**

1. Miratimi nga Ministri i Mbrojtjes i dokumentacionit dhe i vendimit të bordit të standardizimit është pranimi zyrtar i STANAG-ut/AP-së nga Forcat tona të Armatosura. Shpallja e STANAG-ut/AP-së të pranuar bëhet:

- a) në NATO, nga Përfaqësia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë;
- b) në Forcat tona të Armatosura, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nëpërmjet planit të veprimit për zbatimin e STANAG-ut/AP-së, i cili duhet të përmbajë detyrimet për angazhimet e mundshme, kohën e zbatimit, strukturat përgjegjëse dhe ato bashkëpunuese.

2. Për STANAG-un/AP-në e pranuar, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përcakton rregullat dhe strukturën përgjegjëse për regjistrimin dhe arkivimin e tyre.

## Neni 9

### **Konfirmimi për zbatimin e STANAG-ut/AP-së**

Autoriteti kujdestar i STANAG-ut/AP-së dhe personi përgjegjës i standardizimit ndjekin punën për zbatimin e tij, sipas afateve të përcaktuara. Konfirmimi për datën e zbatimit të STANAG-ut/AP-së



bëhet në NATO nga Ministria e Mbrojtjes (pas raportimit të personit përgjegjës dhe autoritetit kujdestar) në gjuhën angleze, sipas modeleve të përcaktuara për këtë qëllim.

Neni 10

Shpenzimet e procesit të zbatimit të STANAG-ut/AP-së mbulohen nga propozuesi, nëpërmjet sistemit të planifikimit dhe zhvillimit të forcës.

Neni 11

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6762, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## LIGJ

**Nr.10 342, datë 28.10.2010**

### **PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHETIT TË VITIT 2009**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

### **Miratimi i buxhetit faktik**

Miratohet buxheti faktik i shtetit i vitit 2009, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

	Në milionë lekë
1. Buxheti i Shtetit	
Të ardhurat, gjithsej	249 169
Shpenzimet, gjithsej	319 903
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
Të ardhurat	74 677
Shpenzimet	73 744
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
Të ardhurat	11 898
Shpenzimet	22 980
4. Deficiti buxhetor	(80 883)
5. Financimi i deficitit buxhetor	80 883
I brendshëm	70 701
A. Me instrumente financiare	

(kredimarrje e brendshme, neto)	43 339
Kredi	21 672
Bono thesari	13 245
Obligacione qeveritare 2/3/5/7-vjeçare	8 422
<b>B. Të ardhura nga privatizimi</b>	<b>25 138</b>
C. Të tjera	2 224
Ndryshimi i gjendjes së arkës	(1 480)
Të tjera	3 704
Financimi i jashtëm, neto	10 182
Nga i cili:	
Mbështetje buxhetore	0.

Neni 2  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6763, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 343, datë 28.10.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 “PËR  
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4, në fund të shkronjës “gj” shtohen fjalët “si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit”.

Neni 2

Në nenin 9 pika 2, pas fjalëve “të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale” shtohen fjalët “të ardhurat nga lojërat e fatit”.

Neni 3

Në nenin 12/3 pika 1, shkronja “ç” shfuqizohet.

#### Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 13

#### **Deklarata individuale vjetore e te ardhurave**

1. Tatimpaguesit individë rezidentë apo të vetëpunësuarit rezidentë, sipas nenit 12 të këtij ligji, që realizojnë të ardhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

2. Përjashtohen nga detyrimi për plotësim të deklaratës vjetore të të ardhurave:

a) tatimpaguesit individë, të cilët gjatë një viti realizojnë të ardhura vjetore jo më shumë se 200 000 lekë;

b) tatimpaguesit që janë të vetëpunësuar e që kanë një qarkullim vjetor deri në 2 000 000 lekë;

c) të gjithë taksapaguesit, të cilët gjatë një viti realizojnë të ardhura vetëm nga paga dhe për të cilat punëdhënësi i ka paguar taksat në burim, të ardhura nga pensioni apo të ardhura nga vetëpunësimi për të cilat i kanë paguar taksat

3. Përveç tatimpaguesve të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, deklaratat vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, si dhe nga personat e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, që duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në këtë ligj.

4. Çdo deklaratë vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kodi fiskal i individit.”.

#### Neni 5

Pas nenit 13 shtohen nenet 13/1, 13/2, 13/3, 13/4, 13/5, 13/6, 13/7, 13/8, 13/9 dhe 13/10 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 13/1

Të dhënat që duhet të përmbajë deklaratat vjetore e të ardhurave:

1. Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore.

2. Deklaruesi, në rast se konstaton gabime materiale të bëra nga ai vetë gjatë plotësimit të deklaratës, ka të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës, të bëjë korrigjimet e nevojshme.

3. Për të përfituar nga shpenzimet e zbritshme për fëmijët dhe për personat në kujdestari, të parashikuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të nenit 13/3 të këtij ligji, pjesa e deklaratës, që i përket këtyre shpenzimeve, plotësohet vetëm nga kryefamiljari.

4. Mënyra e plotësimit nga kryefamiljari e deklaratës për pjesën e shpenzimeve të zbritshme, për rastet e parashikuara në pikat 2 e 3 të këtij neni, rregullohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

#### Neni 13/2

#### **Të dhënat për të ardhurat bruto**

1. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen:

a) të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët dhe fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, që rezulton nga Deklarata e të Ardhurave Personale të Biznesit të Vogël për të vetëpunësuarit;

b) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit;

c) të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit;

ç) të ardhurat bruto nga interesa bankarë;

d) fitimi kapital neto, i krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme;

dh) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;

e) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;

ë) fitimi kapital nga dhurimi;

f) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

g) të ardhura bruto të tjera, të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

2. Të ardhurat e përcaktuara në nenin 8/1 të këtij ligji, nuk përfshihen në të ardhurat bruto për efekt të plotësimit të deklaratës së të ardhurave.

#### Neni 13/3

#### **Shpenzimet e zbritshme**

1. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të tatimpaguesit që plotëson deklaratën vjetore të të ardhurave, janë shpenzime të zbritshme shpenzimet e mëposhtme:

a) pjesa e shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe kontributet vullnetare të pensioneve, sipas përcaktimeve në ligjin për fondet e pensionit vullnetar;

b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;

c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Deklaruesit që kanë të ardhura vjetore prej të paktën 800 000 lekësh nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 13/4

#### **Shkalla tatimore**

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të tatimpaguesit, që plotëson deklaratën vjetore të të ardhurave, është 10 për qind.

#### Neni 13/5

#### **Mbajtja e dokumentacionit**

1. Për çdo të ardhur dhe shpenzim, të referuar në deklaratën vjetore të të ardhurave, tatimpaguesi që bën deklaratën mban kopje origjinale të dokumentit që provon të ardhurën apo shpenzimin e zbritshëm ose fotokopje të njësuar nga institucioni lëshues i dokumentit. Në rastin kur deklarata dorëzohet elektronikisht, dorazi apo me postë, skanime/fotokopje e këtyre dokumenteve i bashkëlidhen deklaratës vjetore të të ardhurave. Originali i tyre, në çdo rast, ruhet në përputhje me legjislacionin fiskal dhe vihet në dispozicion të administratës tatimore, kur kërkohet prej saj.

2. Afati i ruajtjes së dokumentacionit nga individët deklarues është ai i përcaktuar në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 13/6  
**Tatimi për t'u paguar**

1. Diferenca midis totalit të të ardhurave bruto dhe shpenzimeve të zbritshme përbën të ardhurën e tatueshme, e cila tatóhet me normën 10 për qind. Shumës së këtij tatimi i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore.

2. Nëse diferenca është pozitive, deklaruesi, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave, bën pagesën e tatimit. Nëse diferenca është negative, administrata tatimore ia kthen deklaruesit shumën e taksave të paguara më tepër ose, me pëlqim të deklaruesit, kjo shumë mund të përlogaritet si pagesë e kryer për vitin tatimor vijues.

Neni 13/7  
**Dorëzimi i deklaratës**

1. Deklarata dorëzohet në drejtorinë tatimore rajonale më të afërt me vendbanimin e tatimpaguesit, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike.

2. Deklarata hartohet sipas formularit të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 13/8  
**Afatet e ekzekutimit të kreditimit**

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e parashikuar në nenin 13/3 të këtij ligji, kryhet brenda datës 31 shtator të vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën është hartuar deklarata.

Neni 13/9  
**Mosplotësimi në kohë apo plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore vjetore të të ardhurave**

1. Kur administrata tatimore konstaton raste të mosplotësimit në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, për dorëzim.

2. Në rast kur tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep informacion të gabuar apo të rremë e të pakorrigjuar nga ai vetë, brenda afatit të parashikuar nga ky ligj për korrigjimin, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal.

Neni 13/10  
**Udhëzimi i deklaratës vjetore**

1. Ministri i Financave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr udhëzim për zbatimin e neneve 13 deri në 13/9 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr vendim për zbatimin e nenit 13/3 të këtij ligji.”.

Neni 6

Në nenin 21 pika 1, shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 33, pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:  
“g) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.”.

Neni 8  
**Dispozitë kalimtare**

Detyrimi i parë për deklarin e të ardhurave vjetore, nga subjektet e parashikuara në këtë ligj, lind në vitin 2012, në të cilin, brenda datës 30 prill, dorëzohet deklarimi vjetor i të ardhurave për vitin 2011.

Neni 9  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2011.

**Shpallur me dekretin nr.6764, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 344, datë 4.11.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR  
BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR,  
TRAFIKUT TË PALIGJSHËM NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE  
TERRORIZMIT NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6768, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## MARRËVESHJE

### MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM NDERKOMBËTAR TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE TERRORIZMIT NDERKOMBËTAR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Serbisë, e përfaqësuar nga Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Serbisë, këtu të ashtuquajtura si “Palët kontraktuese”,

- në përprejke për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta;  
- të bindur që bashkëpunimi në fushën e luftës kundër krimit ndërkombëtar është i rëndësishëm për të dy vendet;

- të shqetësuar nga rreziku nga përhapja e trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe format e tjera të krimit ndërkombëtar që rrezikojnë sigurinë dhe interesat e tjera vitale të të dyja vendeve;

- duke dëshiruar të koordinojnë aktivitetet në fushën e luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe migracionit të paligjshëm, si dhe mbi bazë të:

Rezolutës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 45/123 të 14 dhjetorit 1990, e cila i referohet bashkëpunimit ndërkombëtar në luftë kundër krimit të organizuar, si edhe mbi bazë të Konventës së vetme mbi drogat narkotike të 30 marsit 1961, në versionin e amenduar nga Protokollin e 25 marsit 1972, si edhe në bazë të Marrëveshjes mbi substancat psikotrope të 21 shkurtit 1971, Marrëveshjes kundër trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, të 20 dhjetorit 1988,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

#### Neni 1

##### Fushat dhe qëllimi i bashkëpunimit

1) Në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, palët kontraktuese do të përkushtohen të bashkëpunojnë dhe të garantojnë asistencë të përbashkët zyrtare për t'u mbrojtur nga rreziqet që kërcënojnë rendin dhe sigurinë publike, si edhe për parandalimin dhe zgjidhjen e shkeljeve penale. Bashkëpunimi në veçanti do të përfshijë fushat e mëposhtme:

1. Kultivimin e paligjshëm, prodhimin, importimin, eksportimin, transportin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

2. Terrorizmin ndërkombëtar;

3. Format e tjera të krimit të organizuar ndërkombëtar, përfshirë trafikun e qenieve njerëzore migracionin e paligjshëm, bashkëpunimin në krim dhe pastrimin e parave.

2) Palët kontraktuese do të asistojnë njëra-tjetrën gjithashtu në kërkimin e personave dhe objekteve, në përputhje me legjislacionet e tyre respektive kombëtare.

#### Neni 2

##### Format e bashkëpunimit

1) Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi i palëve kontraktuese do të zhvillohet në përputhje me rregulloret ligjore kombëtare në fuqi dhe ky bashkëpunim, në mënyrë të veçantë, do të përfshijë:

1. Raportim të përbashkët mbi rrethanat dhe faktet që mund të kontribuojnë për mbrojtjen nga kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike; parandalimin dhe dënimin e shkeljeve penale, me kusht që të dhënat personale të mund të transmetohen vetëm në rastet kur është e nevojshme, për arsye të mbrojtjes nga kërcënimet e lartpërmendura, si edhe për të zgjidhur shkeljet penale të lartpërmendura;

2. Shkëmbim të eksperiencës mbi zbatimin e rregulloreve ligjore, mbi parandalimin e krimit dhe mbi zbatimin e metodave, mjeteve dhe veprimeve që i përkasin fushës së teknikës shkencore;

3. Shkëmbim të eksperiencës midis ekspertëve në fusha të ndryshme të kriminalitetit, si edhe në mbajtjen e takimeve për këta ekspertë;

4. Implementimi i masave të koordinuara policore të rënda dakord nga palët kontraktuese brenda territoreve të tyre respektive, me qëllim për t'u mbrojtur nga kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike, për të parandaluar kryerjen e veprimeve kriminale, si edhe për zgjidhjen me sukses të akteve penale të cilat tashmë janë kryer.

5. Garantimi i asistencës së përbashkët në luftë kundër migracionit të paligjshëm, veçanërisht në rastet që kanë lidhje me shtetasit e shteteve të palëve kontraktuese, si edhe për krijimin e kuadrit kryesor ligjor dhe organizativ për një asistencë të tillë.

2) Palët kontraktuese do të shtrijnë asistencën e ndërsjellë, në përputhje me kërkesat.

3) Secila palë kontraktuese, në përputhje me rregulloret e tyre kombëtare respektive, do t'i japin palës tjetër kontraktuese informacion nga paragrafi 1, pika 1 dhe 2 të këtij neni edhe pa kërkesë, kurdo që ka indikacione specifike për të vepruar kështu, p.sh.: në rast të njohjes së një informacioni të tillë, mund të jetë e nevojshme t'i jepet palës tjetër kontraktuese, me qëllim që të mënjanojë kërcënimin për rendin dhe sigurinë publike, ose për të parandaluar kryerjen e akteve kriminale, si edhe për të zgjidhur shkeljet penale të cilat tashmë janë kryer.

Palët kontraktuese do të shtrijnë asistencën e përbashkët, veçanërisht kur një shkelje penale është duke u përgatitur ose është duke u kryer në territorin e njërës apo të dyja palëve kontraktuese dhe në rastet kur ekziston informacioni, i cili përcakton që në përgatitjen ose kryerjen e një shkeljeje të tillë penale, ka një lidhje me territorin e shtetit të palët tjetër kontraktuese.

### Neni 3

#### **Autoritetet kompetente**

1) Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi përcaktimin e autoriteteve, të cilat, në përputhje me legjislacionin respektiv kombëtar, do të jenë kompetente për të zbatuar bashkëpunimin e përcaktuar në këtë marrëveshje. Ata janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën, në një afat kohor të duhur, mbi ndryshimet e mundshme mbi emrin dhe kompetencën e autoriteteve, të cilat zbatojnë bashkëpunimin e përcaktuar në këtë marrëveshje.

2) Shkëmbimi i informacionit midis palëve kontraktuese nga Organizata Ndërkombëtare Policore Kriminale-Interpol, mund të kryhet me anë të kontaktit direkt midis autoriteteve kompetente.

3) Zbatimi i bashkëpunimit midis palëve kontraktuese mund të kryhet nëpërmjet oficerëve ndërlidhës. Oficeri ndërlidhës kryhen aktivitete këshillimore dhe informuese dhe nuk ka mandat ekzekutiv. Detyrat e oficerit ndërlidhës do të përcaktohen nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar.

### Neni 4

#### **Mbrojtja e të dhënave**

1) Transmetimi i përbashkët i të dhënave personale të administruara midis palëve kontraktuese, do të ekzekutohen mbi bazë të kërkesave të paraqitura, si edhe në përputhje me parimet e mëposhtme, të cilat kanë zbatim identik në procedimin automatik dhe manual të të dhënave.

1. Të dhënat e paraqitura nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, me përjashtim të atyre arsyeve për të cilat këto të dhëna janë transmetuar, pa miratim të mëparshëm të autoritetit i cili i ka dërguar të dhënat.

2. Të dhënat e paraqitura duhet të fshihen ose të korrigjohen, në rastet kur:

a) ato dalin të jenë jokorrekte;

b) autoriteti, i cili ka dërguar ato, është informuar se të dhënat e paraqitura janë siguruar në mënyrë të paligjshme, ose të dhënat janë dërguar në kundërshtim me ligjin;

c) të dhënat nuk janë më të nevojshme për të përmbushur detyrën zyrtare për të cilën të dhënat



janë paraqitur kur ishte e nevojshme, nëse nuk ka një leje të qartë për përdorimin e të dhënave për qëllime të tjera.

3. Në rast të një kërkesë nga autoriteti kompetent që dërgon të dhënat te pala tjetër kontraktuese, autoriteti marrës do të informojë mbi çdo përdorim të të dhënave të marra.

2) Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi të gjitha rrethanat që janë të rëndësishme për të garantuar korrektësinë dhe rifreskimin e të dhënave personale.

3) Të dy autoritetet, ai që siguron të dhënat dhe ai që i merr ato, janë të detyruara të regjistrojnë në dosje/protokolle shpërndarjen, marrjen dhe fshirjen/zhdukjen e të dhënave. Regjistrat e dosjeve/protokolleve do të përmbajnë arsyet për kërkesën për të dhëna, përmbajtjen, autoritetin sigurues dhe marrës, kohën e dorëzimit të të dhënave dhe kohën e fshirjes/shkatërrimit të tyre. Transmetimi i të dhënave nëpërmjet procedurave *on line* do të regjistrohen në mënyrë automatike në dosje. Regjistrat e protokolleve do të mbahen në një periudhë kohore prej të paktën tre vjetësh. Regjistrat e protokolleve mund të përdoren vetëm për kontroll, me qëllimin që të kuptohet nëse rregulloret ligjore efektive në lidhje me ruajtjen e të dhënave janë zbatuar.

4) Me sigurimin e identitetit të tij/saj nga autoriteti përgjegjës për procedimin e të dhënave dhe me kërkesën e tij/saj, çdo person i një rasti të tillë ka të drejtën të informohet mbi të dhënat që kanë lidhje me të, të dhëna të cilat janë siguruar apo transmetuar në përputhje me këtë marrëveshje; ai/ajo gjithashtu ka të drejtën të informohet mbi origjinën e një të dhëne të tillë, qëllimin e kërkesës për përdorimin e këtyre të dhënave si mbi bazat ligjore për këtë të fundit; korrigjimin e të dhënave jokorrekte, si edhe që të dhënat personale të tij/saj që janë transmetuar në mënyrë jo të ligjshme të fshira.

Detajet e procedurës për zbatimin e këtyre të drejtave do të harmonizohen me legjislacionin kombëtar të palës kontraktuese, nën juridiksionin e të cilit janë kryer. Për këtë arsye, palët kontraktuese, nën juridiksionin e të cilit janë kryer. Për këtë arsye, palët kontraktuese garantojnë të paktën nivelin e ruajtjes, që rrjedh nga konventa e Këshillit të Europës nr.108 për mbrojtjen e individëve në lidhje me procedimin automatik të të dhënave personale. Në rast kur kërkesa në lidhje me realizimin e këtyre të drejtave, autoriteti që i disponon të dhënat i ofron autoritetit marrës të të dhënave mundësinë për të adoptuar një qëndrim, përpara marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën.

5) Autoriteti marrës është përgjegjës që në mënyrë të efektshme të ruajë të dhënat e transmetuara nga ndonjë shkatërrim/fshirje/humbje aksidentale/ndryshimin e paautorizuar për transmetimin e mëtejshëm të të dhënave, aksesin e paautorizuar ose shpërndarjen e paautorizuar.

6) Palët kontraktuese garantojnë që, në rast të dhunimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale, personi në fjalë mund të apelojë në një gjykatë të pavarur ose te ndonjë autoritetit tjetër i pavarur dhe se ky person mund të realizojë të drejtën e tij/saj për ndonjë kompensim të mundshëm.

#### Neni 5

#### **Konfidencialiteti**

1) Të dhënat e transmetuara me qëllim realizimin e dispozitave të kësaj marrëveshje do të jenë subjekt i rregulloreve që kanë lidhje me sekretin zyrtar. Pala kontraktuese që i merr të dhënat, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, është e detyruar të sigurojë të njëjtin nivel të sekretit dhe të mbrojtjes të këtyre të dhënave të palës kontraktuese që i ka transmetuar të dhënat.

#### Neni 6

#### **Konsultimet**

1) Në rast të nevojës, menaxherët e autoriteteve shtetërore të palëve kontraktuese nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, janë të autorizuar të kryejnë konsultime me qëllim diskutimin mbi mjetet dhe mënyrat për zbatimin eficient të kësaj marrëveshjeje dhe për masa të tjera për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit.

Neni 7

**Rregullorja e përjashtimeve**

1) Në rast se njëra nga palët kontraktuese vëren se përmbushja e një kërkesë, ose që kryerja e një forme tjetër bashkëpunimi, mund të rrezikojë sovranitetin e saj, sigurinë ose interesa të tjera shtetërore, ose kjo mund të rezultojë në dhunimin e parimeve themelore të sistemit ligjor të njërës prej palëve kontraktuese, pala kontraktuese në fjalë mundet që, në mënyrë të pjesshme ose të plotë, të refuzojë këtë kërkesë, ose mund të kërkojë përmbushjen e disa kushteve të caktuara.

2) Në çdo rast individual, pala kontraktuese kërkuese duhet të informohet mbi vendimin e marrë në lidhje me kërkesën e saj.

Neni 8

**Marrëdhëniet me detyrime të tjera**

1) Dispozitat e kësaj marrëveshje nuk do të paragjykojnë ndonjë detyrim tjetër të ndërmarrë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtar të nënshkruara më parë, të lidhura tashmë nga palët kontraktuese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

**Hyrja në fuqi dhe përfundimi**

1) Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë nga dita kur palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën që kushtet e parashikuara dhe që rrjedhin nga rregulloret kombëtare ligjore të shteteve të palëve kontraktuese në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, janë përmbushur.

2) Palët kontraktuese lidhen në këtë marrëveshje për një periudhë të pacaktuar kohore. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe shtohet në çdo kohë, në rastet kur palët kontraktuese bien dakord për këtë paraprakisht.

3) Palët kontraktuese mund të përfundojnë këtë marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga marrja e njoftimit diplomatik të dërguar nga pala tjetër kontraktuese.

Bërë më \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_ në dy kopje të njëjta, në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet të barasvlershme.

Në rast keqinterpretimi, teksti anglisht do të ketë epërsi.

**LIGJ**

**Nr.10 345, datë 4.11.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 8093, DATË 21.3.1996 “PËR REZERVAT UJORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 61 paragrafi i dytë shkronja “a”, shifra “500 000 (pesëqind mijë) lekë” zëvendësohet me shifrën “2 000 000 (dy milionë) lekë”.

Neni 2

Pas nenit 71 shtohet neni 71/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 71/1

Këshilli i Ministrave miraton formularin përkatës, ku dokumentohen procedurat e zbatuara nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, sipas përcaktimeve të shkronjës “c” të nenit 61 të këtij ligji.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6769, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr.10 346, datë 4.11.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9874, DATË 14.2.2008 “PËR  
ANKANDIN PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 13 shtohet pika 13/1 me këtë përmbajtje:

“13/1. “Komisioni i Prokurimit Publik” është institucioni i ngritur sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të shitjes me ankand bëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik.”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- a) Në shkronjën “b”, pas fjalëve “procedurave të ankandeve publike” shtohen fjalët “pas nënshkrimit të kontratës”.
- b) Shkronja “ç” shfuqizohet.
- c) Në shkronjën “d”, fjalët “vendos dhe” hiqen.

#### Neni 3

Në nenin 27 pika 1, fjalët “Agjencinë e Prokurimit Publik” zëvendësohen me fjalët “Komisionin e Prokurimit Publik”.

#### Neni 4

Në nenet 42 dhe 44 fjalët “Agjencia e Prokurimit Publik” dhe “Agjencia” zëvendësohen me fjalët “Komisioni i Prokurimit Publik” dhe “Komisioni”.

#### Neni 5

Pas nenit 42 të kreut VII “Procedurat e rishikimit administrativ” shtohet neni 42/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 42/1

#### **Organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve**

1. Shqyrtimi administrativ i ankesave të ofertuesve ndaj procedurave të ankandit apo vendimit për përjashtim nga procedurat e ankandit, sipas shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, bëhet nga Komisioni i Prokurimit Publik.
2. Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.
3. Rregulla të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të ankandit apo vendimeve për përjashtim nga këto procedura miratohen nga Këshilli i Ministrave.”.

#### Neni 6

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 2, 4, 5 e 8, fjalët “brenda 5 ditëve” zëvendësohen me fjalët “brenda 7 ditëve”.
2. Në fjalinë e fundit të pikës 5, pas fjalëve “i dërgohet” shtohet fjala “detyrimisht”.
3. Në fund të fjalisë së parë të pikës 6, pas fjalëve “përshkrimi i shkeljes” shtohen fjalët “pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit shitës”.
4. Në fund të pikës 7 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:  
“Autoriteti kontraktues i dërgon menjëherë informacion Komisionit të Prokurimit Publik, kur merr dijëni se ankesa i është paraqitur këtij Komisioni.”.
5. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:  
“9. Çdo ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifa e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

#### Neni 7

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

**Të drejtat e Komisionit të Prokurimit Publik**

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të sigurohet që autoriteti shitës e ka pezulluar procedurën e ankandit. Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim nëse do të lëshojë ose jo një urdhër të ndërmjetëm, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, dhe vë në dijeni për këtë autoritetin shitës.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin shitës, me anë të një urdhri të ndërmjetëm, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e ankandit, nëse:

- a) ka të dhëna se ankimuesi nuk do të ketë sukses me ankesën;
- b) pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin shitës ose ofertuesit.

3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit shitës ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit shitës, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin shitës të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e lidhjes së kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

4. Pas lidhjes së kontratës, kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit shitës është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji;

c) të marrë masa ndaj personave përgjegjës, sipas parashikimeve në këtë ligj.

5. Kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një punonjës i autoritetit shitës ka kryer një shkelje të qëllimshme, që prek parimet dhe qëllimin e këtij ligji, përveç masave korrigjuese të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mund të bëjë kallëzim penal në organet përkatëse.”.

Neni 8

Pas nenit 43 shtohen nenet 43/1 e 43/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 43/1

**Procedura e rishikimit administrativ**

1. Komisioni i Prokurimit Publik mund të fillojë një procedurë rishikimi administrativ kur i paraqitet ankesë nga persona të interesuar për procedura ankandi.

2. Gjatë rishikimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) t'u kërkojë palëve dokumentacion ose të dhëna, për të mbështetur pretendimet e tyre;

b) të kërkojë të dhëna e shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin administrativ;

c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me procedurën e rishikimit;

ç) të kërkojë ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta.

3. Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të caktojë një afat për përgjigjen ndaj kërkesave të tij për të dhënat dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.

#### Neni 43/2

### Vendimet e komisionit të prokurimit publik

1. Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:

a) të pushojë gjykimin, duke qenë se veprimet ose mosveprimet e autoritetit shitës, që ka realizuar procedurën e ankandit, nuk përbëjnë shkelje të këtij ligji ose të dispozitave administrative apo penale. Në këtë rast, Komisioni i Prokurimit Publik i sqaron, me shkrim, ankimuesit arsyet për pushimin e gjykimin;

b) t'i japë autoritetit shitës, të përfshirë, një vendim me shkrim, për të ndalur sjelljen e jashtëligjshme, brenda një afati të caktuar kohor.

2. Autoritetet shitëse duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për vendimin. Nëse këto veprime i kanë sjellë efektet e tyre, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik u këshillon personave të dëmtuar të ngrenë padi në gjykatë ose të bëjnë kallëzim penal.

3. Nëse Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një zyrtar i autoritetit shitës ka kryer një shkelje të qëllimshme të këtij ligji, atëherë ia raporton shkeljen autoritetit përkatës.”.

#### Neni 9

Në nenin 44 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët “në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë” zëvendësohen me fjalët “në gjykatën kompetente”.

2. Fjalja e dytë e pikës 1 hiqet.

#### Neni 10

### Dispozita kalimtare

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ankesat ndaj procedurave të ankandit bëhen në Komisionin e Prokurimit Publik.

2. Komisioni vazhdon shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në gjendjen në të cilën ato ndodhen.

3. Shqyrtimi i ankesave ndaj procedurave të ankandit nga Komisioni i Prokurimit Publik fillon pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 11

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6770, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 4.11.2010**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS FLORINA NUNI KOMISIONERE NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit në detyrë,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zonja Florina Nuni zgjidhet komisionere në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.68, datë 4.11.2010**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ANILA NEPRAVISHTA KOMISIONERE NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit në detyrë,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zonja Anila Nepravishta zgjidhet komisionere në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.69, datë 4.11.2010**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARBEN SHKËMBI KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit në detyrë,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Arben Shkëmbi zgjidhet komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.70, datë 4.11.2010**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT RAMIZ ÇOBAJ ANËTAR I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e përfaqësuesve të mbledhjes së pushtetit vendor,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Ramiz Çobaj zgjidhet anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, në vend të zonjës Vera Shtjefni, e cila ka dhënë dorëheqjen.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**



**VENDIM**  
**Nr.71, datë 4.11.2010**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT FATMIR TAJ ANËTAR I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zoti Fatmir Tafaj zgjidhet anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, në vend të zotit Sajmir Mani, të cilit i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.840, datë 21.10.2010**

**PËR VENDOSJEN E KABLOS NËNDETARE NDËRKOMBËTARE ME FIBËR OPTIKE BARI (ITALI) - GJIRI I LALZIT (SHQIPËRI), PROJEKTI “BALKANS - ITALY NETWORK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin, në parim, të vendosjes, në ujërat tona territoriale, të kablos nëndetare ndërkombëtare me fibër optike Bari (Itali) - Gjiri i Lalzit (Shqipëri), projekti “Balkans - Italy Network”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lejimin e shoqërisë UNIFI Holdings Inc. – dega Shqipëri, për të kryer studimin përkatës dhe për shtrirjen e kablos nëndetare ndërkombëtare me fibër optike Bari (Itali) – Gjiri i Lalzit (Shqipëri).

3. Afati i kësaj leje, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Autorizohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për dhënien e lejeve e të informacioneve përkatëse për pikën hyrëse, në Gjirin e Lalzit, të kablos nëndetare ndërkombëtare sipas rregullave në fuqi.

5. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.862, datë 27.10.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.34, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SISTEMIMIN NË APARTAMENTE BANIMI TË FAMILJEVE, QË BANOJNË NË TERRITORIN E PORTIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 11.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe të neneve 34/1 e 39/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.34, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 fjalët “... me kontratë qiraje ...” shfuqizohen.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Enti Kombëtar i Banesave të bëjë privatizimin e këtyre objekteve për familjet e personave të caktuar në listën emërore bashkëlidhur këtij vendimi, sipas procedurave që përcaktohen në udhëzimin nr.19, datë 13.9.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Procedurat e privatizimit të objekteve dhe lidhja e kontratës të bëhen brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në rast se personi, sipas pikës 3 të këtij vendimi, nuk paraqitet pranë EKB-së të lidhë kontratën brenda afatit 6-mujor, familjes i humbet e drejta e privatizimit dhe objekti duhet të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave në zbatim të programit të banesave sociale me kosto të ulët.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Enti Kombëtar i Banesave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.952, datë 24.11.2010**

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË ZHVILLOJË PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “NDËRTIMI I RRUGËS KOMUNA E PARISIT - RRUGA E RE, TIRANË - ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si autoritet kontraktor, të zhvillojë procedurën e prokurimit, me objekt “Ndërtimi i rrugës Komuna e Parisit - Rruga e Re, Tiranë - Elbasan”, brenda vitit 2010.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.968, datë 1.12.2010**

**PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSISË NATYRORE),  
NË KOMUNAT DHE BASHKITË NË QARKUN E SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “c”, e 6 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), si pasojë e përkeqësimit të kushteve natyrore të motit, në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës.

2. Ngritjen e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, i cili të kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Ministrin e Brendshëm;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministrin e Financave;
- Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit;
- Ministrin e Shëndetësisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile;
- Drejtorin e Përgjithshëm të KESH-it.

3. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile të bashkërendojë punën me ministritë e linjës, me institucionin e prefektit, Shkodër, dhe me njësitë e qeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e emergjencës civile, për hartimin dhe zbatimin e planit të evakuimit të banorëve të zonave të prekura, për krijimin e kushteve të këtyre banorëve për jetesë, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse e rehabilituese në infrastrukturën dhe mjedisin e prekur nga situata e krijuar.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, ministritë e linjës, prefekti i qarkut Shkodër, si dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.970, datë 1.12.2010**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.2, DATË 9.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE**  
**CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR**  
**NGA PËRMBYTJET NATYRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shkronja “A” e pikës 1 të vendimit nr.2, datë 9.1.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Shuma prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh nga fondi rezervë i buxhetit;”.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.971, datë 1.12.2010**

**PËR DHËNIE FONDI PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE, TË KRIJUAR NË**  
**QARKUN E SHKODRËS, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e një fondi, deri në kufirin prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, për t’u përdorur nga Ministria e Brendshme, në programin buxhetor “Emergjenca civile”, për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga përmbytjet natyrore. Ky fond klasifikohet si shpenzim nga të ardhurat jashtë limitit (kapitulli 6).

2. Fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh mbulohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe kalimi i tij, për llogari të Ministrisë së Brendshme, bëhet në bazë të shpenzimeve faktike, të kryera për përballimin e kësaj situate.

3. Njësitë vendore të qarkut të Shkodrës, në situatë emergjente, dhe objekti i përdorimit të këtij fondi, të përcaktohen nga Komiteti Ndërmintoror i Emergjencës Civile.

4. Kriteret dhe procedurat e përdorimit të këtij fondi të përcaktohen me një udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.721, datë 27.10.2010**

**PËR KRITERET E ORGANIZIMIT DHE TË DREJTIMIT TË QENDRAVE TË KËSHILLIMIT  
TË KONSUMATORËVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 8 të Kushtetutës, si dhe nenit 54 pika 1 shkronja “b”, e nenit 49, pika 2 shkronja “f” të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

**UDHËZON:**

1. Qëllimi i udhëzimit është përcaktimi i kriterëve për organizimin dhe drejtimin e qendrave për këshillimin e konsumatorëve nga shoqatat e konsumatorëve.

2. Qendrat e këshillimit të konsumatorëve duhet të jenë kompetente për të dhënë këshilla mbi çështje të lidhura me konsumatorët, të tilla si:

a) mbrojtjen e interesave ekonomikë të konsumatorëve në lidhje me:

i) informacionin mbi mallrat dhe shërbimet, etiketimin, treguesit e çmimeve, garancinë etj.;

ii) praktikën e padrejta tregtare;

iii) kushtet e padrejta të kontratave;

iv) publicitetet çorientuese, krahasuese etj.;

v) shitjet jashtë qendrave të tregtimit, si dhe në distancë;

vi) shërbimet financiare dhe kreditë konsumatore;

vii) paketat e udhëtimit etj.

b) sigurinë dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve për konsumatorët;

c) mbrojtjen ligjore dhe dëmshpërblimin e konsumatorëve, përfshirë këtu edhe procedurat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të ankesave të konsumatorëve.

d) si dhe informacione të tjera të nevojshme për të drejtat e konsumatorëve të parashikuara në legjislacionin shqiptar.

3. Qendrat e këshillimit të konsumatorëve duhet të veprojnë si njësi të veçanta, nëpërmjet zyrave/ambienteve përkatëse. Këto zyra/ambiente duhet të jenë në vende lehtësisht të arritshme nga konsumatorët dhe duhet të kenë të treguara qartë si jashtë, ashtu dhe brenda ndërtesës ku janë vendosur, emërtesën: Qendra e Këshillimit të Konsumatorëve, të shoqëruar me emrin e shoqatës që e drejton.

Emërtesa mund të tregojë gjithashtu edhe emrin e donatorit që e mbështet, në rast se ka një të tillë.

4. Qendrat e këshillimit të konsumatorëve duhet të kenë pajisje të përshtatshme të teknologjisë së informacionit (kompjuter të lidhur në internet, printer, faks etj.), pajisje zyre, si dhe linjë telefonike, për të siguruar thirrjet nga konsumatorët.

5. Qendrat për këshillim të konsumatorëve duhet të operojnë me kohë të plotë ose të pjesshme. Në çdo rast, duhet të tregohet orari i funksionimit të qendrës, në mënyrë të qartë dhe të dallueshme.

6. Personeli i qendrës së këshillimit të konsumatorëve preferohet të ketë arsim të lartë, njohuri mbi procedurat administrative, aftësi kompjuterike dhe njohje me metodat e komunikimit dhe punës në rrjet, eksperiencë të mjaftueshme pune në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe trajnime për këto çështje.

7. Personeli i caktuar për qendrat e këshillimit të konsumatorëve duhet të ketë njohuri të mira mbi:

a) legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit dhe ligjet e tjera të lidhura me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve;

b) procedurat për pranimin dhe/ose dërgimin e ankesave për t'i parashtruar pranë METE-s apo organeve të tjera përkatëse, duke përdorur:

i) formularin e ankesave të konsumatorit; ose

ii) sistemin e menaxhimit të ankesave të konsumatorit;

iii) manuale të ndryshme që do të përdoren për qëllime të këshillimit, informimit dhe të trajtimit të ankesave nga konsumatorët.

c) Procedurat dhe funksionimin e shërbimit, në rastin e përdorimit të “call center”.

8. Personeli i caktuar për qendrat e këshillimit të konsumatorëve duhet:

a) të veprojnë në mënyrë të ndershme, etike dhe profesionale;

b) të mos diskriminojnë për arsye të racës, gjinisë, fesë, mendimit politik, kombësisë, origjinës shoqërore, ose karakteristikave të tjera dalluese;

c) të garantojnë një trajtim të bazuar në respektimin e personit, pa përdorur detyrim/presion psikik ose fizik, abuzim me fjalë apo trajtim poshtëruës;

d) t’u sigurojnë konsumatorëve informacion të paanshëm;

e) të mos kërkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, asnjë lloj kompensimi, ryshfeti apo dhurata të çfarëdolloji;

f) të mbrojnë të drejtat e konsumatorëve në lidhje me ruajtjen e informacionit konfidencial, për të cilin personeli merr dijëni.

9. Qendrat e këshillimit të konsumatorëve mund të kontribuojnë në edukimin e konsumatorëve përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe broshurave informuese.

10. Shoqata e konsumatorëve që drejton qendrën e këshillimit, i jep një informacion të përgjithshëm strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, në lidhje me aktivitetin vjetor të funksionimit të qendrës. Ky informacion paraqitet në muajin e parë të vitit pasardhës.

11. Lista e qendrave të këshillimit të konsumatorëve, që plotësojnë kriteret e këtij udhëzimi, publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

12. Ngarkohet struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve për publikimin dhe përditësimin e listës së qendrave të këshillimit sipas kriterëve dhe kërkesave të këtij udhëzimi.

13. Udhëzimi hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,  
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Ilir Meta**

#### **VENDIM**

*(I shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.2080, datë 22.7.2010, vendosi shpalljen të vdekur, më datë 10.5.1999, të shtetasit Lutfi Mara, i biri i Jakupit dhe i Bajames, lindur më 5.1.1962, në Shënavlash Durrës.



**Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.**

**Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 3.12.2010  
Doli nga shtypi më 3.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT  
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë